



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Ligji Nr.2004 / 21**

**PËR VETERINARINË**

Kuvendi i Kosovës,

Duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/ 9 të dt. 15 maj 2001 për Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, Kreu 9.1.26 (a) dhe 5.1. (j),

Me qëllim të vendosjes dhe përforsimit të kërkesave në fushën e veterinarisë, shëndetit publik veterinar, prodhimet mjekësore veterinarë, ushqimeve të kafshëve, mirëqenie të kafshëve dhe rregullimit të profesionit të veterinarisë,

Aprovon:

**LIGJIN PËR VETERINARINË**

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet luftimi dhe parandalimi i sëmundjeve infektive të kafshëve, praktika mjekësore veterinarë, qarkullimi i kafshëve të gjalla, produkteve me origjinë shtazore, kontrolli veterinar i importit, eksportit dhe kalimit tranzit të kafshëve të gjalla dhe produkteve me origjinë shtazore, përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të institucioneve qeveritare dhe komunale, si dhe të individëve në këtë fushë.

Zbatimi

Neni 2

2.1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për :

a Kërkesat në lëmin e veterinarisë:

- i Lidhur me shëndetin e kafshëve dhe shëndetin publik përsa i përket kafshëve të gjalla duke përfshirë produktet embrionale, sperma, qelizat dhe embrionet e racave vendore dhe të racave tjera që mund t'i aprovojë Ministri me propozimin e Kryeshefit Ekzekutiv të Veterinarisë e që i nënshtrohen kërkesave veterinarë;
- ii Me qëllim të rregullimit të shëndetit të kafshëve dhe shëndetit publik përsa i përket produkteve me origjinë shtazore, duke përfshirë nënproduktet: lista e detajuar e këtyre produkteve (nënproduktet të cilat nuk janë në listën e Aneksit

II të Traktatit të Bashkimit Evropian) do të përshkruhet në Udhëzimin Administrativ të nxjerrë nga Ministri, dhe prodhimeve bimore. Lista e detajuar e prodhimeve bimore të cilat veçanërisht për arsye të destinimit pasues të tyre, mund të paraqesin rrezikun e përhapjes së sëmundjeve infektive ose ngjitëse të kafshëve dhe të cilat i nënshtrohen inspektimeve veterinarë, do të përcaktohet me Udhëzim Administrativ të nxjerrë nga Ministri.

- b Kërkesat lidhur me prodhimet mjekësore veterinarë;
- c Kërkesat lidhur me ushqimet e kafshëve, të cilat ndikojnë në shëndetin e kafshëve dhe shëndetit publik.

## 2.2. Rregullimin e:

- a Të drejtave dhe detyrimet e personave fizikë dhe juridikë në fushën e aktiviteteve veterinarë;
- b Të drejtave dhe obligimeve të personave që ushtrojnë aktivitete private veterinarë; dhe organizimin dhe zbatimin e aktiviteteve të tyre;
- c Organizimin, fushëveprimin e kompetencave dhe fuqive të organeve që kryejnë aktivitete publike veterinarë.

## Definicionet

### Neni 3

Termet e përdorura në këtë ligj kanë këto domethënje:

"**Kafshë**" nënkupton të gjitha kafshët e gjalla, duke përfshirë peshqit dhe bletët, larvat që jetojnë të lira dhe format larvare riprodhuese, por pa përfshirë format fetale ose embrionale;

"**Pika e inspektimi kufitar**" nënkupton pikën e inspektimit, të caktuar dhe aprovuar për kryerjen e inspektimeve veterinarë të kafshëve të gjalla, produkteve me origjinë shtazore, produkteve embrionale, spermës, qelizave dhe embrioneve, nënprodukteve dhe produkteve bimore që u nënshtrohen kërkesave veterinarë të destinuara për import në kufi dhe pikat kufitare administrative të territorit të Kosovës;

"**Kontakt i rrezikshëm**" nënkupton kafshën, e cila në çfardo mënyre i është ekspozuar infektimit ose është në rrezik të infektimit me një sëmundje nga lista e Programit të Parë;

"**SHVUK**" nënkupton Shërbimin Veterinar dhe të Ushqimit të Kosovës;

"**KEV**" nënkupton Kryeshefin Ekzekutiv të Veterinës i SHVUK-ut;

" **Ushqimet e kafshëve** " nënkupton produktet me origjinë bimore ose shtazore, të freskëta ose të konservuara, duke përfshirë produktet që rrjedhin nga përpunimi industrial i tyre dhe substancat organike, të përdorura veçmas ose në përzierje, me ose pa aditiv, për ushqim gojor të kafshëve;

"**Eksport**" nënkupton lëvizjen ose kalimin e kafshëve të gjalla, produkteve me origjinë shtazore, produkteve biologjike, spermës, qelizave dhe embrioneve, nënprodukteve dhe produkteve bimore që u nënshtrohen kërkesave veterinarë nga territori i Kosovës në një vend të jashtëm;

**"Importi"** i referohet lëvizjes ose kalimit të mallrave të kafshëve të gjalla, produkteve me origjinë shtazore, produkteve biologjike, spermës, qelizave dhe embrioneve, nënprodukteve dhe produkteve bimore që u nënshtrohen kërkesave veterinare nga një vend i jashtëm në territorin e Kosovës;

**"Infektim"** nënkupton prezencën e agjentëve të sëmundjeve patogjene në një kafshë të gjallë, në produkte me origjinë shtazore ose produkte biologjike, spermës, qelizave dhe embrioneve, nënprodukteve dhe produkteve bimore që u nënshtrohen kërkesave veterinare;

**"Ministër"** nënkupton Ministrin përgjegjës për shërbimet veterinare;

**"Veterinar zyrtar"** nënkupton veterinarin e autorizuar për të kryer aktivitete publike veterinare;

**"Veteriner"** nënkupton banorin e Kosovës, i cili me sukses ka kompletuar aftësim formal për mjekësi ose kirurgji veterinare në një fakultet të veterinarisë të aprovuar zyrtarisht nga Ministri kompetent;

**"Teknik i veterinars"** nënkupton banorin e Kosovës, i cili me sukses ka kompletuar programin katërvjeçar për teknik të veterinars siç mësohet në shkollat e mesme në Kosovë ose ka kualifikim ekuivalent të njohur nga Ministri kompetent;

**"Plasim në treg"** nënkupton mbajtjen ose ekspozimin për shitje, ofrimin për shitje, shitjen, dorëzimin ose çdo formë tjetër e ofrimit për konsum, ruajtje, transporti për qëllime të shitjes dhe importin për qëllime të shitjes;

**"Aktiviteti privat veterinar"** ka kuptimin që i është dhënë në nenin 33;

**"Aktivitetet publike veterinare"** ka kuptimin që i është dhënë në nenin 34;

**"Zona e mbrojtur"** nënkupton çdo zonë e cila mund të shpallet zyrtarisht nga Ministria që është zonë që shtrihet në një rreze minimale prej tri kilometrash dhe një zone të vëzhgimit me rreze prej dhjetë kilometrave, duke marrë parasysh kufijt natyralë, ku prezenca e një sëmundjeje që duhet të lajmërohet është diagnostifikuar dhe ku masat do të ndërmerren, në pajtim me dispozitat e këtij Ligji, për kontrollin dhe çrënjosjen e sëmundjeve të dhëna në Programin e Parë;

**"Shërbimet veterinare"** nënkupton organet në Kosovë ose në vende të tjera të autorizuara të kryejnë aktivitete publike veterinare;

**"Produkt mjekësor veterinar"** nënkupton produktet mjekësore profilaktike dhe terapeutike për përdorim tek kafshët;

**"Periudha e ndalimit (tërheqjes)"** nënkupton periudhën kohore, e cila mund të përcaktohet nga KEV, me referencë për kafshët ose llojet e veçanta të kafshëve, gjatë të cilës prodhimi ose produktet me origjinë shtazore nuk mund të konsumohen ose shiten për konsum nga njerëzit a kafshët pasi të jenë dhënë ose përdorur produktet mjekësore veterinare;

**"Mishi"** përfshin mishin e përfitur nga shpendët, gjedhët, derrat, delet, kuajt, dhitë, peshqit ose kafshët e tjera dhe mishi i përfitur nga kafshët dhe shpezët e egra.

## Kërkesat veterinare

### Neni 4

Në kuptim të këtij Ligji kërkesat veterinare përfshijnë:

- a Masat sa i përket kafshëve të gjalla dhe produkteve biologjike, spermës, qelizave dhe embrioneve, nënprodukteve dhe produkteve bimore që u nënshtrohen kërkesave veterinare lidhur me:
  - i Kontrollin e sëmundjeve infektive dhe ngjitëse;
  - ii Lajmërimin për disa sëmundje të caktuara të specifikuar nga Ministria;
  - iii Identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve;
  - iv Kushtet shëndetësore të kafshëve që kërkohen për lëvizjen e tyre;
  - v Kushtet shëndetësore të kafshëve që kërkohen për importimin e tyre.
- b Masat për produktet me origjinë shtazore lidhur me:
  - i Kërkesat për prodhimin dhe plasimin e tyre në treg;
  - ii Kushtet që kërkohen për importin e tyre;
- c Masat në lidhje me kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë shtazore për sa i përket:
  - i Ndalesës për dhënien dhe përdorimin e substancave të caktuara;
  - ii Monitorimit të substancave dhe mbetjeve të caktuara;
  - iii Mbeturinave të kafshëve dhe patogjenëve;
- d Masat sa i përket inspektimeve veterinare që kanë të bëjnë me eksportin e kafshëve të gjalla, produkteve me origjinë shtazore dhe produkteve biologjike, spermës, qelizave dhe embrioneve, nënprodukteve dhe produkteve bimore që u nënshtrohen kërkesave veterinare ;
- e Çertifikimi në lidhje me kontrollet veterinare;
- f Marrëdhëniet me organizatat e tjera ndërkombëtare lidhur me çështjet veterinare.

## SHVUK

### Neni 5

5.1. Shërbimi Veterinar dhe i Ushqimit të Kosovës (më tutje SHVUK) është Agjenci Ekzekutive në kuader të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përgjegjëse për shëndetin e kafshëve dhe kontrollin e sigurinë e ushqimit me prejardhje shtazore, organizimi dhe veprimtaria e të cilës rregullohet me këtë ligj dhe me Udhëzimin Administrativ të nxjerrë nga Ministria.

5.2. SHVUK ka njësitë veta organizative nëpër Komuna dhe ushtron fuqitë dhe funksionet e veta në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë depot e doganave dhe zonat e lira.

5.3. SHVUK udhëhiqet nga Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencionit, i cili zgjidhet sipas legjislacionit në fuqi.

5.4. KEV bën rekomandime përmes Ministrit përkatës të degët përkatëse të qeverisë dhe subjektet tjera jashtë ministrie për çështjet që ndërlidhen me SHVUK-un.

5.5. Agjencia Ekzekutive SHVUK, implementon legjislacionin nga fushëveprimi i kompetencave të saj nën drejtimin e Ministrit dhe në kuader të MBPZHR-së.

## Neni 6

6.1. I SHVUK organizon dhe siguron në bazë të programeve monitoruese dhe kërkesave ligjore, monitorimin dhe kontrollin nëpër fushat e paraqitura më poshtë:

- a Parandalimi dhe luftimi i sëmundjeve infektive të kafshëve;
- b Kontrolli i sigurisë së ushqimit me prejardhje shtazore;
- c Mirëqenia e kafshëve;
- d Qarkullimi i produkteve me origjinë shtazore në përputhje me ndarjen e autorizimeve midis ministrive për të siguruar mbikëqyrjen dhe kontrollin mbi trajtimin e ushqimit;
- e Qarkullimi i mbeturinave me origjinë shtazore;
- f Qarkullimi i medikamenteve veterinare, produkteve farmaceutike veterinare dhe produkteve tjera për kujdesin ndaj kafshëve;
- g do të marr pjesë së bashku me autoritetet kompetente në qarkullimin e ushqimit të kafshëve si dhe të shtesave të ushqimit;
- h Regjistrimi i fermave, matrikullimi i kafshëve dhe tufave, shejimi i tufave , kontrolli i lëvizjeve të kafshëve dhe
- i Kontrolli, ekspektiza veterinare dhe klasifikimi i trupave të mishit.

6.2. SHVUK në kuadër të fushëveprimit të kompetencave të tij ka të drejtë që:

- a Të hartojë aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji;
- b Të hartojë udhëzime për luftimin e sëmundjeve infektive të kafshëve;
- c Të sigurojë mundësinë për të ofruar shërbimet laboratorike;
- d Të përfaqësojë Kosovën përpara organizatave ndërkombëtare dhe të mbajë kontaktet ndërkombëtare në fushën e mjekësisë veterinare; dhe
- e Të përgatisë kërkesat dhe t'ia dorëzojë entitetit kompetent për kryerjen e hulumtimeve shkencore.

6.3. SHVUK formulon, miraton dhe mirëmban një sistem të protokolimit, regjistrimit dhe lëvizjes së kafshëve dhe produkteve me origjinë shtazore, si edhe një sistem, funksioni i të cilit është të raportojë rastet e kafshëve që sëmuhen nga sëmundjet infektive .

## Kryeshefi Ekzekutiv i SHVUK-ut

### Neni 7

#### KEV:

- a Është këshilltari kryesor për Ministrinë për të gjitha çështjet që ndërlidhen me shëndetin e kafshëve ose veterinën publike ose që ndërlidhen ose janë në lidhje me SHVK-në.
- b Dorëzon raporte periodike në Ministri mbi aktivitetet në zhvillim të veterinës publike;
- c I raporton Ministrisë çfarëdo informate mbi dëshmitë ose faktet e reja shkencore, të cilat mund të ndikojnë direkt ose indirekt në aktivitetet e veterinës publike;
- d I dorëzon Ministrisë dokumentacionin ose të dhënat e kërkuara për përgatitjen e rregullave dhe/ose instrumenteve të tjera ndihmëse në pajtim me dispozitat e këtij Ligji;
- e Bashkëpunon me shërbimet ose organet e tjera veterinare të Kosovës mbi çështjet që bien nën përgjegjësi të tij / saj,
- f Kryen detyra dhe funksione që i janë caktuar në pajtim me dispozitat e këtij Ligji dhe në përgjithësi monitoron aktivitetet veterinare që janë duke u kryer.
- g Konfirmon ekzistencën e sëmundjeve të dhëna në listë në Programin e Parë; dhe
- h KEV mund të zgjidhet personi që është së paku Veteriner i diplomuar që ka së paku 10 vjet përvojë në profesion.

## Kontrolli i sëmundjeve infektuese dhe ngjitëse

### Neni 8

8.1. Për kontrollimin dhe parandalimin e sëmundjeve infektuese dhe ngjitëse të kafshëve, Ministri në bazë të listës së sëmundjeve të dhëna në Programin e Parë mund të klasifikojë sëmundjet e caktuara si të rrezikshme dhe që kërkojnë masa të veçanta të kontrollit veterinar dhe të nxjerr Udhëzim Administrativ për:

- a Vendosjen e procedurave të pranuar për përcaktimin e diagnozës zyrtare të infektimit;
- b Përcaktimin e obligimeve për laboratorë, pronarët e kafshëve, të produkteve me origjinë shtazore dhe produkteve biologjike, spermës, qelizave dhe embrioneve, nënprodukteve dhe produkteve bimore që u nënshtrohen kërkesave veterinare, duke përfshirë obligimin për t'i raportuar SHVUK-ut ekzistencën ose dyshimin e ekzistencës së çfarëdo sëmundje infektuese ose sëmundje nga programi i parë;
- c Përcaktimin e masave kufizuese për lëvizjen e kafshëve të gjalla, produkteve me origjinë shtazore dhe produkteve biologjike, spermës, qelizave dhe embrioneve, nënprodukteve dhe produkteve bimore që u nënshtrohen kërkesave veterinare në rast të dyshimit ose konfirmimit të infektimit, duke përfshirë obligimin për pronarët që të kufizojnë lëvizjen e kafshëve, produkteve me origjinë shtazore ose

- produkteve të dyshimta të pezulluara, në pritje të hulumtimit veterinar nga ana e ShVUK-ut;
- d Përcaktimin e procedurave të veçanta për shenjimin dhe identifikimin e kafshëve;
  - e Përcakton trajtim dhe/ose vaksinim të detyrueshëm të kafshëve të gjalla;
  - f Përcaktimin e dispozitave për izolimin e kafshëve të gjalla, produkteve me origjinë shtazore dhe produkteve biologjike, spermës, qelizave dhe embrioneve, nënprodukteve dhe produkteve bimore që u nënshtrohen kërkesave veterinarë që me arsye dyshohet ose zyrtarisht është e diagnostifikuar se janë të infektuara;
  - g Sigurimin e therrjes së detyrueshme të kafshëve të dyshuara ose të konfirmuara si të infektuara, si dhe metodat për hedhjen dhe asgjësimin e sigurt të trupave të tyre;
  - h Sigurimin e shkatërrimit të sigurtë të produkteve me origjinë shtazore dhe produkteve biologjike, spermës, qelizave dhe embrioneve, nënprodukteve dhe produkteve bimore që u nënshtrohen kërkesave veterinarë të dyshuara ose konfirmuara si të infektuara;
  - i Sigurimin që kur sëmundjet zhvillohen gjatë transportimit të kafshëve, personi përgjegjës për transport të njoftojë SHVUK-n, në pajtim me dispozitat e këtij Ligji ose rregullave që mund të nxirren sipas tij;
  - j Sigurimin që kur të ketë rrezik se kafshët e egra mund të përhapin sëmundje të caktuara infektuese në kafshët shtëpiake ose njerëz, KEV në konsultim me Departamentin e Pylltarisë të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, organizon dhe definon masat për trajtimin, vaksinimin dhe/ose reduktimin e numrit të kafshëve të egra të prekura ose të limiton në ndonjë mënyrë tjetër lëvizjen e tyre;
  - k Themelimin e laboratorit për diagnostifikimin e sëmundjeve të kafshëve;
  - l Hartimin e planeve për raste të papritura me pjesëmarrjen e organeve për zbatimin e ligjit, autoriteteve komunale dhe organeve për mbrojtje civile për të zbatuar dispozitat më lartë.

8.2. Me qëllim të sigurimit të parandalimit, kontrollit dhe/ose çrrënjësjes së sëmundjeve infektive të kafshëve të dhëna në Programin e parë dhe të dytë, ShVUK:

- a Grumbullojn informatat e domosdoshme për analizën e gjendjes epizootike dhe enzotike në dhe jashtë Kosovës, në vitin në vazhdim dhe vitet paraqake;
- b Formulon dhe aprovon një sistem për vlerësimin dhe analizën e të dhënave të grumbulluara;
- c Vlerëson rreziqet prej sëmundjes në bazë të sistemeve të lart cekura;
- d Formulon programet e nevojshme të dedikuara monitoruese ;
- e Formulon planet për parandalimin, kontrollin dhe kur të jetë e mundshme, planet për çrrënjësje dhe këto plane para zbatimit të tyre i dorëzon për aprovim te Ministri përgjegjës për financa;

- f Bashkëpunon me Institutin e Shëndetit Publik për të formuluar dhe zbatuar programet për parandalimin, kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektuese që prekin si kafshët ashtu edhe njeriun-zoonozat;
- g Bashkëpunon me Departamentin e Pylltarisë të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) për të formuluar dhe zbatuar programet e parandalimit, kontrollit dhe çrrënjosjes të sëmundjeve infektuese të kafshët e egra, që prekun kafshët shtëpiake dhe njeriun-zoonozat.

8.3. KEV përmes tenderit autorizon, dhe kontraktin veterinarët privatë për të asistuar në zbatimin e programeve të monitorimit, parandalimit, kontrollit dhe çrrënjosjes së sëmundjeve të cilat implementohen nga SHVUK-u

8.4. Veterinarët e tillë privatë marrin kompensim përkatës varësisht prej natyrës së shërbimeve të kryera, siç mund të përcaktohet me Udhëzim Administrativ të nxjerrë nga Ministri;

8.5. Ministri mund të nxjerrë Udhëzim Administrativ sipas këtij Ligji për kontrollimin e sëmundjeve specifike të kafshëve në pajtimin me standardet ndërkombëtare për sëmundje.

## Masat financiare

### Neni 9

9.1. Burimet financiare të SHVK-së, të cilat vijnë nga Fondi i Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës do shfrytëzohen:

- a Për shpenzimet e SHVUK-ut;
- b Për implementimin e programeve të SHVUK-ut dhe
- c Për pjesëmarrjen në forumet ndërkombëtare në koordinim me organin kompetent.

9.2. Mjetet financiare, të cilat rrjedhin nga Buxheti i Kosovës me qëllim të çrrënjosjes së sëmundjeve përbëhen nga:

- a Mjetet financiare dhe kompensimet brenda kornizës së një emergjence, të shpallur me Vendim të Ministrit; dhe
- b Mjetet financiare për implementimin e skemave të vendosura për çrrënjosjen e sëmundjeve të veçanta.

9.3. Në rast të shpërthimit të ndonjë sëmundje nga lista e Programit të Parë, SHVUK definon zonat e mbrojtura dhe të vëzhguara si dhe pronarët e kafshëve marrin kontribute financiare prej SHVUK-ut për çrrënjosjen e sëmundjes, siç mund të vendos Ministri për çdo rast të veçantë, varësisht prej kushteve prej të cilave përbëhen masat e zbatuara, e së paku, izolimi i pronës nga koha e dyshimit për prezencën e sëmundjes e deri te konfirmimi zyrtar i ekzistencës së sëmundjes si dhe:

- a SHVUK urdhëron therrjen e dhunshme të llojeve të kafshëve të prekshme nga sëmundjet, të cilat janë prekur ose kontaminuar ose të dyshuara se janë prekur ose kontaminuar, dhe shkatërrimin i tyre;



- b SHVUK urdhëron shkatërrimin e ushqimeve të kontaminuara dhe pajisjeve të kontaminuara, në rastet kur artikujt e kontaminuar nuk mund të dezinfektohen në pajtim me nenin 9.3 (c) dhe
- c SHVUK urdhëron pastrimin, dezinfektimin, desinsektimin dhe deratizimin e pronave dhe të pajisjeve në ato prona.

9.4. Pronarët e kafshëve kanë të drejtë të marrin kontribute publike financiare vetëm kur masat e definuara nga SHVUK për të parandaluar rrezikun e përhapjes së infektimit janë respektuar dhe kur është respektuar periudha e pritjes e vendosur dhe vëzhguar nga SHVUK pas therjes dhe para rimbushjes së objektit të fermes.

9.5. Kontributet publike financiare, nëse është e përshtatshme, mund të ndahen në kategori. Kontributi, i cili duhet të jetë i arsyeshëm dhe i dhënë pa vonesë limitohen në:

- a Pagesën e kostos së drejtpërdrejtë që e kanë pasur pronarët në thertore, për shkatërrimin e kafshëve dhe kur është e arsyeshme edhe të produkteve të tyre, për pastrimin, desinsektim, deratizim e dezinfektim e pronave dhe pajisjeve dhe për shkatërrimin e ushqimeve dhe pajisjeve të kontaminuara të përmendura në nenin 9.3 (b) ose
- b Shërbime veterinarë dhe vaksina falas kur SHVUK ka urdhëruar që kafshët, tipet ose llojet e caktuara të kafshëve, duhet të vaksinohen.

9.6. Dispozitat e neneve 9.3, 9.4 dhe 9.5 zbatohen, pavarësisht nga ekzistenca e çfardo programi të çrrënjësës, në pajtim me dispozitat e nenit 10.1 .

9.7. Ministri me Udhëzim Administrativ mund të ndryshojë listën e sëmundjeve të dhëna në Programin e Parë dhe Dytë, duke shtuar ndonjë sëmundje që ka mundësi të paraqes rrezik për shëndetin publik ose shëndetin e kafshëve në Kosovë dhe duke hequr ato sëmundje që nuk janë relevante për shëndetin publik dhe të kafshëve në Kosovë.

## Kontributi financiar për Programin për tërë territorin e Kosovës

### Neni 10

10.1. Në bazë të dispozitave të këtij Ligji, KEV mund të krijojë Programin për tërë territorin e Kosovës për parandalimin, kontrollin dhe çrrënjësin e sëmundjeve të dhëna në Programin e Dytë.

10.2. Ministri mundet, në marrëveshje me Ministrin përgjegjës për financa, të nxjerrë Udhëzim Administrativ për zbatimin e dispozitave të këtij neni e sidomos përsa i përket:

- a Sëmundjeve, të cilat i nënshtrohen Programit për tërë territorin e Kosovës për parandalim, kontrollin ose çrrënjësin;
- b Kushtet nën të cilat pronari i kafshëve mund të marr kontributin financiar publik nga SHVUK për çrrënjësin e këtyre sëmundjeve; dhe
- c Kontributin financiar publik dhe shërbimet tjera të ofruara nga SHVUK brenda kornizës së Programit.

## Lajmërimi i sëmundjeve

### Neni 11

11.1. SHVUK brenda njëzet e katër orëve nga momenti i paraqitjes së sëmundjes duhet të njoftojë vendet e tjera si dhe Zyrën Ndërkombëtare të sëmundjeve Epizootike (OIE), për:

- a Shpërthimin primar apo sekondar në Kosovë, të cilësdo sëmundje nga lista e Programit të parë dhe nga të gjitha zbulimet përcjellëse në bazë të kodit ndërkombëtar të shëndetit të kafshëve; dhe
- b Pas çrrënjësjes së rastit të fundit të sëmundjes së paraqitur, heqjen e kufizimeve të vëna me rastin e shpërthimit të asaj sëmundjeje.

11.2. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 11.1, KEV lajmëron vendet e tjera, më së voni në ditën e parë të punës të secilës javë, për shpërthimet e tjera të cilësdo sëmundje nga lista e Programit të Parë dhe të konfirmuara se ekzistojnë në Kosovë.

11.3. Lajmërimet e përmendura në nenet 11.1 dhe 11.2 komunikohen në mënyrën e përcaktuar nga KEV.

## Identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve

### Neni 12

12.1. Ministri mund të nxjerrë Udhëzime Administrative sipas këtij Ligji që vendosin sistemet për identifikim dhe regjistrim të kafshëve.

12.2. SHVUK formulon, aprovon dhe mirëmban një sistem të regjistrimit dhe shënimit të lëvizjes së kafshëve, produkteve shtazore dhe produkteve me origjinë shtazore.

## Identifikimi dhe regjistrimi i qenve dhe maceve

### Neni 13

Në pajtim me procedurat e vendosura nga Ministri, Autoritetet Komunale kryejnë:

- a Regjistrimin e qenve;
- b Vaksinimin vjetor kundër tërbimit dhe dehelmentizimin kundër ekinokokeve;
- c Kapjen e qenve dhe maceve të rrugës dhe nëse është e nevojshme, eutanazinë e tyre;
- d Largimin dhe hedhjen e sigurt e trupave të përmendura në pikën (c);
- e Themelimin e vendeve për përkujdesje për qentë dhe macet, sipas nevojës.

## Lëvizja e kafshëve të gjalla, produkteve shtazore dhe produkteve embrionale

### Neni 14

14.1. Ministri mund të nxjerrë Udhëzim Administrativ sipas këtij Ligji përsa i përket kushteve shëndetësore dhe kërkesave për çertifikim që duhet të përmbushen në lidhje me lëvizjen e kafshëve të gjalla, produkteve shtazore dhe produkteve embrionale.

14.2. SHVUK formulon, aprovon dhe mirëmban sistemin e regjistrimit, shënimit të lëvizjes së kafshëve të gjalla, produkteve shtazore dhe produkteve embrionale.

## Kushtet e importit të kafshëve të gjalla , produkteve me origjinë shtazore dhe produkteve embrionale.

### Neni 15

15.1. Ministri mund të nxjerrë Udhëzim Administrativ sipas këtij Ligji përsa i përket kushteve, dhe veçanërisht kushteve shëndetësore dhe karantinimin e tyre, sipas të cilave kafshët e gjalla, produktet me origjinë shtazore dhe produktet embrionale mund të importohen nga vendet tjera.

15.2. KEV dërgon për publikim në Gazetën Zyrtare:

- a Listën e shteteve nga të cilat është i autorizuar importi i kafshëve të gjalla produkteve me origjinë shtazore dhe produkteve embrionale në Kosovë;
- b Listën e qendrave grumbulluese, subjekteve të aprovuara, institucioneve ose qendrave të autorizuara për import të kafshëve të gjalla dhe produkteve embrionale në Kosovë;
- c Mostrën e çertifikatës për llojet e ndryshme të kafshëve të gjalla, produkteve me origjinë shtazore dhe produkteve embrionale që importohen në Kosovë;
- d Listën e ndërmarrjeve jashtë Kosovës, të autorizuara të eksportojnë produkte me origjinë shtazore në Kosovë;

15.3. Për importin të kafshëve të gjalla, produkteve me origjinë shtazore dhe produkteve embrionale, kërkohet çertifikata shëndetësore veterinarë e aprovuar nga vendi eksportues.

15.4. Ministri, me propozimin e KEV-it, mund të nxjerrë Udhëzim Administrativ për vendosjen e pikave për dezinfektimin e automjeteve në pikat e kontrollit kufitar dhe në qendra tjera dhe për dezinfektimin, dezinfektimin dhe trajtimin antiparazitik të kafshëve të importuara që qarkullojnë brenda Kosovës, ose që eksportohen.

Prodhimi, përpunimi dhe plasimi në treg i kafshëve dhe  
produkteve me origjinë shtazore

Neni 16

16.1. Ministri mund të nxjerrë Udhëzim Administrativ sipas këtij Ligji për prodhimin, përpunimin, dhe plasimin në treg të kafshëve dhe produkteve me origjinë shtazore.

16.2. KEV dërgon për publikim në Gazetën Zyrtare listën e tregjeve të aprovuara për kafshët dhe ndërmarrjet e aprovuara për përpunimin dhe plasimin në treg të produkteve me origjinë shtazore.

Kushtet e eksportit të kafshëve të gjalla, produkteve me origjinë shtazore  
dhe produkteve embrionale

Neni 17

17.1. Ministri mund të nxjerrë Udhëzim Administrativ sipas këtij Ligji për kushtet shëndetësore, sipas të cilave kafshët e gjalla, produktet me origjinë shtazore dhe produktet embrionale mund të eksportohen në vendet tjera.

17.2. KEV dërgon për publikim në Gazetën Zyrtare:

- a Listën e qendrave grumbulluese, organeve të aprovuara, institucioneve ose qendrave, të autorizuar për eksport të kafshëve të gjalla dhe produkteve embrionale nga Kosova;
- b Mostrën e certifikatën për llojet e ndryshme të kafshëve të gjalla dhe produkteve embrionale që eksporthen nga Kosova.

17.3. Për eksportin e kafshëve të gjalla dhe produkteve me origjinë shtazore jashtë Kosovës kërkohet çertifikata shëndetësore veterinarë e aprovuar nga SHVUK.

Ndalimi i përdorimit të substancave të caktuara dhe  
përdorimi i mbetjeve dhe patogjenëve

Neni 18

Ministri nxjerrë Udhëzim Administrativ sipas këtij Ligji për:

- a Ndalimin e përdorimit, në blegtori të substancave, të cilat kanë veprim hormonal ose tirostatik dhe të stimuluesve të rritjes dhe të metaboliteve të gjedhëve dhe substancave të tjera të cilat mund të jenë të dëmshme për shëndetin publik; dhe
- b Masat që duhet të ndërmerren për monitorimin e substancave dhe mbetjeve të tyre në kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë shtazore;
- c Masat që duhet ndërmarrë për hedhjen dhe përpunimin e mbetjeve të kafshëve dhe patogjenëve, për plasimin e tyre në treg, dhe për parandalimin e patogjenëve në ushqimet e kafshëve me origjinë shtazore dhe të peshqëve.

## Inspektimet veterinare të kafshëve të gjalla dhe produkteve me origjinë shtazore

### Neni 19

19.1. Ministri në konsultim me Drejtoritë Komunale përkatëse mund të nxjerrë Udhëzime Administrative sipas këtij Ligji për:

- a Inspektimet veterinare që duhet të kryhen te kafshët e gjalla, produktet embrionale, mbetjet e kafshëve, patogjenët dhe produktet me origjinë shtazore, të cilat janë të destinuara për treg dhe të cilat i nënshtrohen tregut;
- b Masa që duhet të ndërmerren gjatë inspektimit të kryer në vendin e origjinës dhe në vend-destinim të dërgesës ose gjatë transportimit. Mënyrën në të cilën shpenzimet për masat e përshkruara në nenin 19/b mbulohen nga dërguesi i mallrave ose përfaqësuesi i tij ose nga personi përgjegjës për kafshët ose produktet me origjinë shtazore;
- c Masat që duhet të ndërmerren në rastet kur SHVUK në Kosovë vërteton prezencën e patogjenëve për sëmundje të përmendura në Programin e Parë, zoonozë, sëmundje tjetër, ose çfarëdo shkaktari që paraqet rrezik të madh për shëndetin e kafshëve ose shëndetin publik;
- d Lëshimin e çertifikatës pas inspektimit dhe kontrollit veterinar të kafshëve të gjalla dhe produkteve shtazore dhe të përshkruaj rregullat mbi taksat që duhet paguar sa i përket çdo aktiviteti të inspektimit.

19.2. Në rastet e përmendura në nenin 19/1a dhe b, KEV mund të urdhërojë ndërmarrjen e masave të menjëhershme emergjente dhe të vendos kontakte të drejtpërdrejta me personat, organizatat ose administratat përkatëse në Kosovë ose jashtë Kosovës.

## Importi i kafshëve të gjalla dhe produkteve me origjinë shtazore

### Neni 20

20.1. SHVUK nuk autorizon lëshimin, në qarkullim të lirë në Kosovë të kafshëve të gjalla ose produkteve me origjinë shtazore, duke përfshirë produktet biologjike, spermës, qelizave dhe embrioneve, nënprodukteve dhe produktet bimore që u nënshtrohen kërkesave veterinare, të importuara në Kosovë, përveç nëse janë plotësuar kushtet e dhëna në këtë nen.

20.2. Ministri mund të nxjerrë Udhëzim Administrativ sipas këtij Ligji për veprimet që duhet pasuar inspektimin e kafshëve të gjalla dhe produkteve me origjinë shtazore.

20.3. KEV mund të urdhërojë ndërmarrjen e menjëhershme të masave emergjente dhe vendos kontakt me personat, organizatat ose administratat përkatëse në Kosovë dhe jashtë kur :

- a Në vendin eksportues manifestohet ose shpërndahet çfarëdo sëmundje nga Programi i Parë, zoonozë ose sëmundje tjetër ose ndonjë rrethanë tjetër që paraqet rrezik serioz për shëndetin e kafshëve dhe shëndetin publik;
- b Ka ndonjë arsye tjetër serioze për shëndetin e kafshëve dhe shëndetin publik që arsyetohet me zbulimet e ekspertëve të veterinarisë të vendit eksportues ose në

bazë të inspektimeve të ndërmarra në pikën kontrolluese kufitare të shtetit eksportues; dhe

- c Çfarëdo inspektimi që rrjedh nga ky nen tregon se dërgesa e kafshëve të gjalla ose produkteve me origjinë shtazore, duke përfshirë produktet biologjike, spermen, qelizat, embrionet, nënproduktet dhe produktet bimore që u nënshtrohen kërkesave veterinare, mund të paraqesin rrezik për shëndetin e kafshëve dhe të njeriut.

20.4. Shpenzimet e ndërlidhuara me masat e përshkruara në nenin 20.3 mbulohen nga dërguesi i mallit ose përfaqësuesi i tij ose nga personi përgjegjës për kafshët ose produktet me origjinë shtazore.

20.5. Ministri mund të nxjerrë Udhëzim Administrativ për aprovimin e vendosjes së pikave inspektuese kufitare në Kosovë dhe për pezullimin e tyre, për arsye që lidhen me shëndetin publik dhe të kafshëve.

## Marrëdhëniet me vendet tjera në fushën e veterinës

### Neni 21

Ministri, në bashkëpunim me organin kompetent, mund të nxjerrë Udhëzim Administrativ sipas këtij Ligji përsa i përket asistencës dhe kooperimit, të cilat SHVUK duhet t'ia ofrojnë vendeve tjera që të sigurohet zbatimi i duhur i rregullave të veterinës, parandalimi dhe zbulimi i shkeljeve të rregullave të tilla dhe zbulimi i aktiviteteve të cilat janë ose mund të jenë në kundërshtim me to.

## Ushqimi i kafshëve

### Neni 22

22.1. SHVUK siguron ekspertizë për autoritetet kompetente për mbrojtjen e shëndetit publik dhe të kafshëve që i referohen ushqimit të kafshëve, në çështjet e mëposhtme:

- a Aditivët. të cilët mund të inkorporohen në ushqime, përdorimi i produkteve të caktuara dhe ndalimi i substancave të padëshiruara dhe produkteve të përdorura në ushqimin e kafshëve;
- b Metodat e mostrimit dhe analizës së ushqimeve dhe vlerësimin e produkteve dhe aditivëve të përdorur në ushqimin e kafshëve;
- c Inspektimet që duhet të kryhen në ushqimet e importuara nga vendet tjera;
- d Kushtet e ndalimit për përdorimin e ushqimeve të medikuara;
- e (e) Taksat që paguhet për shërbimet e ofruara nga SHVUK në sektorin e ushqimit të kafshëve;
- f (f) Lajmërimin e Departamentit të Blegtorisë të MBPZHR-së, kur verifikohet ndonjë parregullsi nga SHVUK;

22.2. Ministri mund të kërkojë që ushqimet e kafshëve që nuk janë në pajtim me këtë nen të tërhiqen, shkatërrohen, ripërpunohen ose të rieksporthen dhe të ndalohet therrja e kafshëve që kanë konsumuar këto ushqime për konsum njerëzor për një periudhë të caktuar.

## Aditivët

### Neni 23

Pas konsultimit me organet relevante teknike, Ministri mund të nxjerrë Udhëzim Administrativ për përdorimin e aditivëve që mund të inkorporohen në ushqime dhe përdorimin dhe tregtimin e enzimave dhe mikroorganizmave për qëllime të ushqimit të kafshëve si dhe mund të ndalojë përdorimin e substancave të caktuara të padëshiruara për t'u përdorur në ushqimin e kafshëve.

## Produktet mjekësore veterinare

### Neni 24

Brenda fushëveprimit të këtij Ligji, kërkesat në fushën e produkteve mjekësore veterinare përfshijnë:

- a Kërkesat për tregtim të produkteve mjekësore veterinare;
- b Vendosjen e standardeve analitike, farmakotoksikologjike dhe klinike si dhe protokoleve për testimin e produkteve mjekësore veterinare;
- c Procedurat që duhet zbatuar për autorizimin dhe mbikëqyrjen e prodhimit, qarkullimit dhe përdorimit të produkteve mjekësore veterinare dhe
- d Taksat që duhet vjelur për autorizimin dhe mbikëqyrjen e produkteve mjekësore veterinare.

### Neni 25

Ministri mund të nxjerrë Udhëzime Administrative sipas këtij Ligji për:

- a Tregtimin e produkteve mjekësore veterinare;
- b Standardet analitike, farmakotoksikologjike dhe klinike si dhe protokolet për testimin e produkteve mjekësore veterinare;
- c Autorizimin dhe mbikëqyrjen e produkteve mjekësore veterinare të dhëna në Programin e Tretë.

## Taksat

### Neni 26

Ministri, në bashkëpunim me Ministrinë përgjegjëse për financat, mund të nxjerrë Udhëzim Administrativ sipas këtij Ligji për taksat që ngarkohen për shërbimet e ofruara nga SHVUK sipas dispozitave të këtij Ligji.

## Obligimet e personave në fushën e aktiviteteve të veterinarës

### Neni 27

Pronari, mbajtësi, tregtari ose importuesi, marrësi i ngarkesës, transportuesi, shitësi ose cilido person i autorizuar sipas dispozitave të këtij Ligji të shesë kafshët e gjalla, produktet me origjinë shtazore, produktet biologjike, spermën, qelizat dhe embrionet, nën-produktet dhe produktet bimore që u nënshtrohen kërkesave veterinarë, ushqimet e kafshëve ose produktet mjekësore veterinarë, ose perfaqësuesit e personave të tillë, ose cilido person i ngarkuar me një aktivitet privat veterinar që i nënshtrohet dispozitave të këtij Ligji duhet:

- a. Të deklarojë aktivitetin e tij në SHVUK dhe organet tjera kompetente në pajtim me dispozitat e këtij Ligji;
- b. T'iu ofrojë zyrtarëve të SHVUK-ut, veterinarit zyrtar ose personelit të tij të autorizuar bashkëpunimin dhe asistencën e domosdoshme në përmbushjen e aktivitetit publik veterinar. Këta persona nga ana e tyre duhet:
  - i Të lejojnë kryerjen e inspektimeve veterinarë, ekzaminimin ose inspektimin e kafshëve të gjalla, produkteve me origjinë shtazore, produkteve biologjike, spermës, qelizave dhe embrioneve, nën-produkteve dhe produktet bimore që u nënshtrohen kërkesave veterinarë, ushqimeve të kafshëve dhe produkteve mjekësore veterinarë;
  - ii Të mbajnë dhe transportojnë kafshët në pajtim me dispozitat e këtij Ligji përsa i përket kontrolleve dhe ekzaminimeve identifikuese të kafshëve, vaksinimit parandalues dhe çrënjosjes së sëmundjeve;
  - iii Të grumbullojnë, transportojnë dhe tregojnë produktet me origjinë shtazore, produktet biologjike, spermën, qelizat dhe embrioneve, nën-produkteve dhe produktet bimore që u nënshtrohen kërkesave veterinarë , ushqimet dhe produktet veterinarë në pajtim me dispozitat e këtij Ligji përsa i përket kontrolleve ose inspektimeve të produkteve të tilla, ushqimeve dhe prodhimeve mjekësore veterinarë;
  - iv T'i lejojnë qasje SHVUK-ut në çdo kohë, siç mund të kërkojë rasti, në vendet ku kafshët e gjalla, produktet me origjinë shtazore, produktet biologjike, sperma, qelizat dhe embrionet, nën-produktet dhe produktet bimore që u nënshtrohen kërkesave veterinarë, ushqimet e kafshëve ose produktet mjekësore veterinarë mbahen ose transportohen; dhe
  - v. Të asistojnë zyrtarët e SHVUK-ut në trajtimin që ata konsiderojnë se është i domosdoshëm të kryhet në produktet me origjinë shtazore, produktet biologjike, spermë, qeliza dhe embrione, nënprodukte dhe produkte bimore që u nënshtrohen kërkesave veterinarë, ushqimet e kafshëve ose produktet veterinarë mjekësore;
- c. Të respektojë obligimet që rrjedhin nga ky Ligj përsa i përket sëmundjeve ngjitëse dhe të zbatojë rregullat që ndërlidhen me to. Këta persona duhet:
  - i Të bashkëpunojnë dhe asistojnë në kontrollin e sëmundjeve infektuese dhe ngjitëse dhe në deklarimin dhe lajmërimin në SHVUK-ut të çdo dyshim për cilën do sëmundje ngjitëse nga lista e Programit të Parë;



- ii Të respektojnë detyrimet e vëna nga SHVUK në rast të paraqitjes të secilës sëmundje nga lista e Programit të Parë, duke përfshirë detyrimin për ndalesat në lëvizje të kafshëve dhe njerëzve, therjen e kafshëve, shkatërrimin e produkteve shtazore, ushqimet e kafshëve dhe pajisjeve dhe pastrimin e dezinfektimin e objekteve, materialit dhe pajisjeve përcjellëse;
  - iii Të identifikojnë dhe regjistrojnë kafshët dhe deklarojnë lëvizjen e kafshëve për të cilën ata janë përgjegjës;
  - iv Të mbajnë regjistra individualë për secilën pronë, për të cilën ata janë përgjegjës;
  - v Të respektojnë kushtet shëndetësore në lidhje me lëvizjen e kafshëve të gjalla dhe produkteve embrionale;
  - vi Të tregojnë çertifikatat dhe dokumentet e domosdoshme në rast kërkesë nga secili zyrtar i SHVUK-ut;
  - vii Të deklarojnë dhe lajmërojnë SHVUK-un për çdo dyshim për shfaqjen e ndonjë sëmundjeje nga lista e Programit të Dytë, të cilat janë objekt i programit të Kosovës për çrrënjosje të sëmundjes;
  - viii Të respektojnë obligimet e vëna nga SHVUK për sa i përket dyshimit të shfaqjes së sëmundjeve nga lista e Programit të Dytë që janë objekt i programit të Kosovës për çrrënjosje, duke përfshirë obligimet sa i përket kufizimeve të lëvizjes së kafshëve, therjes së kafshëve, shkatërrimit të produkteve shtazore, ushqimeve të kafshëve dhe pajisjeve, dhe pastrimin dhe dezinfektimin e objekteve, materialeve relevante dhe pajisjeve;
- d. Të plotësojë kushtet për sa i përket importit të kafshëve të gjalla, produkteve embrionale dhe produkteve me origjinë shtazore dhe t'i pajis operatorët e jashtëm me modelet përkatëse të çertifikatave, të cilat përdoren për sa i përket llojeve të ndryshme të kafshëve të gjalla, produkteve embrionale dhe produkteve me origjinë shtazore;
  - e. Të tregojë çertifikatat dhe dokumentet e nevojshme, në kërkesë të zyrtarëve të SHVUK-ut;
  - f. Të lajmërojë SHVUK-un për çfarëdo dyshimi për zoonoza, helmim, sëmundje tjetër ose çfarëdo fenomeni apo rrethana të tjera që mund të paraqesin rrezik serioz për shëndetin e kafshëve ose shëndetin publik;
  - g. Të veprojnë në përputhje me pezullimin ose tërheqjen e çfarëdo aprovimi zyrtar nga ana e zyrtarëve të SHVUK-ut, në bazë të rezultateve të inspektimit të kryer nga zyrtarët e tillë, ose pas përdorimit apo prodhimit të substancave ose produkteve të paautorizuara nga personi i tillë;
  - h. Të respektojë detyrimet e caktuara nga SHVUK që kanë të bëjnë me kufizimin e tregtisë së produkteve të deklaruara të papërshtatshme për konsum njerëzor ose substancat dhe produktet e paautorizuara ose që kanë të bëjnë me shkatërrimin e produkteve me origjinë shtazore, të cilat paraqesin rrezik serioz për shëndetin e kafshëve ose shëndetin publik;

- i. Të respektojë masat e shëndetit të kafshëve gjatë prodhimit dhe plasimit në treg të kafshëve të gjalla dhe produkteve me origjinë shtazore dhe në bazë të kërkesës të zyrtarëve të SHVUK-ut të nxjerrë çertifikatat dhe dokumentet e domosdoshme;
- j. Të respektojë periudhën e tërheqjes nga shitja dhe përdorimi i kafshëve të gjalla dhe produkteve me origjinë shtazore, sipas dispozitave të këtij Ligji;
- k. Të asistojë SHVUK-un në monitorimin e substancave të caktuara dhe mbetjeve të tyre në kafshët e gjalla dhe produkteve me origjinë shtazore sipas dispozitave të këtij Ligji;
- l. Të paguajë taksat relevante për inspektimet dhe kontrollet e përmendura në këtë nen ose në çfarëdo Udhëzimi Administrativ që mund të nxirret sipas këtij Ligji, dhe
- m. Të asistojë dhe bashkëpunojë me SHVUK-un, në aktivitete të caktuara për evitimin e shpërthimit të sëmundjeve të kafshëve dhe për kontrollin e tyre.

Monitorimi i substancave të caktuara, mbetjeve të kafshëve dhe patogjenëve

#### Neni 28

Pronari, mbajtësi, tregtari ose importuesi, marrësi i ngarkesës, transportuesi, shitësi ose çdo person i autorizuar, sipas dispozitave të këtij Ligji, të shesë kafshë të gjalla, produkte me origjinë shtazore, produkte biologjike, spermë, qeliza dhe embrione, nënprodukte dhe produkte bimore që u nënshtrohen kërkesave veterinarë, ushqime të kafshëve ose produkte mjekësore, ose përfaqësuesi i personave të tillë, ose çdo person i ngarkuar me një aktivitet privat veterinar që i nënshtrohet dispozitave të këtij Ligji duhet:

- a Të asistojë SHVUK në monitorimin e substancave të caktuara dhe mbetjeve të tyre në kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë shtazore, sipas këtij Ligji;
- b Të plasojë në treg vetëm kafshë, të cilave nuk iu kanë dhënë substanca ose produkte të pa autorizuar apo, të cilat nuk kanë kaluar asnjë trajtim ilegal që është në kundërshtim me dispozitat e këtij Ligji;
- c Të mos plasojë në treg e as të therrë kafshë, të cilat janë trajtuar me produkte mjekësore veterinarë, përveç nëse periudha relevante e tërheqjes është respektuar para se kafshët të jenë plasuar në treg ose therrur;
- d Të refuzojë çdo kafshë të dorëzuar drejtpërdrejt ose përmes ndërmjetësit, për të cilat prodhuesi nuk është në gjendje të garantojë se periudha e ndalimit (tërheqjes) është respektuar;
- e Të vendosë nën kontroll zyrtar, kur i kërkohet kjo gjë nga një zyrtar i shërbimeve veterinarë, çfarëdo substance dhe produkti të pautorizuar, derisa të merren masat përkatëse nga SHVUK;
- f Të pajtohet me urdhërat për pezullimin ose tërheqje të çdo autorizimi ose aprovimi të dhënë paraprakisht nga SHVUK.

- g Të pajtohet me të gjitha urdhërat që kufizojnë ose ndalojnë tregtinë me produkte të deklaruara të papërshtashme për konsum njerëzor ose nga kafshët dhe urdhëresat për shkatërimin e produkteve me origjinë shtazore që paraqesin rrezik serioz për shëndetin e kafshëve dhe shëndetin publik;
- h Të paguajë taksat relevante për inspeksionet dhe kontrollat e përmendura në këtë nen, ose në çfarëdo Udhëzimi Administrativ që mund të nxirret; dhe
- i Të asistojë dhe bashkëpunojë me SHVUK-un në çdo aktivitetet e të tij, të orjentuara në evitimin e shpërthimit të sëmundjeve të kafshëve ose për kontrollin e tyre.

#### Detyrimet në lidhje me tregtinë dhe importet

##### Neni 29

Pronari, mbajtësi, tregtari importuesi, marrësi i dërgesës, transportuesi, shitësi ose cilido person i autorizuar sipas dispozitave të këtij Ligji, të shesë kafshë të gjalla, produkte me origjinë shtazore, produkte biologjike, spermë, qeliza dhe embrione, nënprodukte dhe produkte bimore që u nënshtrohen kërkesave veterinarë, ushqime ose produkte mjekësore veterinarë, ose përfaqësuesit e personave të tillë, ose cilido person i ngarkuar për një aktivitet privat veterinar që i nënshtrohet dispozitave të këtij Ligji duhet:

- a Të plasojë në treg vetëm ato kafshë të cilat janë identifikuar drejt dhe të cilat nuk janë objekt i çfarëdo kufizimi të lëvizjes për shkak të dyshimit, shpërthimit ose ekzistencës së sëmundjeve të përmendura në listën e Programit të Parë ose për shkak të aplikimit të masave të rrezikut;
- b Të mos mbahet në pronë dhe as të mos nxirret në treg asnjë kafshë, përderisa nuk jepet garancioni se ajo kafshë është e liruar nga një ose më shumë sëmundje nga lista e Programit të Dytë, sipas dispozitave të këtij Ligji;
- c Të refuzojë çdo kafshë të dorëzuar drejtpërdrejtë ose përmes ndërmjetësit, që nuk janë identifikuar drejt dhe për të cilat prodhuesi nuk është në gjendje të garantojë se kafsha nuk është objekt i çfarëdo kufizimi të lëvizjes për shkak të dyshimit, shpërthimit ose ekzistencës së sëmundjes së përmendur në Programin e Parë ose për shkak të aplikimit të masave të kujdesit;
- d Të mos pranojë në një pronë, qendër, organizatë, ose në treg ndonjë kafshët për të cilat nuk janë siguruar garancitë e kërkuara sipas dispozitave të këtij Ligji që tregojnë se kafshët e tilla janë të liruara prej sëmundjeve nga lista e Programit të Dytë;
- e Të sigurojë që kafshët e destinuar për tregti ose therrje plotësojnë kërkesat shëndetësore të specifikuar në këtë nen ose në çfarëdo Udhëzimi Administrativ të nxjerrë sipas tij;
- f Para se kontigjenti të jetë ndarë ose më pas të jetë tregtuar, të kontrollojë se a janë të pranishme shenjat e identifikimit, çertifikatat ose dokumentet dhe të lajmërojë SHVUK-un për çfarëdo parregullsie ose anomalie dhe në rastin e dytë të izolojë kafshët në fjalë derisa SHVUK të marrë vendim për parregullsinë ose anomalinë e lartpërmendur;

- g Të raportojë paraprakisht ardhjen e kafshëve dhe produkteve prej vendeve të tjera dhe në veçanti për natyrën e dërgesës dhe datën e paraparë të ardhjes;
- h Të mbajë certifikatat shëndetësore ose dokumentet e ndërlidhura me dispozitat e këtij Ligji për një periudhë jo më të shkurtër se gjashtë muaj dhe jo më të gjatë se pesë vjet, siç mund të përcaktohet nga SHVUK, për t'ia prezantuar SHVUK, nëse ky e kërkon një gjë të tillë;
- i Të sigurojë se produktet me origjinë shtazore të destinuara për tregti janë siguruar, kontrolluar, shenjëzuar dhe etiketuar në pajtim me dispozitat e këtij Ligji dhe i janë përcjellur marrësit të fundit të shoqëruara me një certifikatë shëndetësore të kafshëve ose nga ndonjë dokument tjetër që mund të kërkohej;
- j Të sigurojë se produktet me origjinë shtazore të destinuara për tregti plotësojnë kërkesat e dispozitave të këtij Ligji dhe Udhëzimeve Administrative të nxjerrë sipas tij;
- k Të sigurojë se produktet me origjinë shtazore të destinuara për tregti janë në pajtim me kërkesat veterinarë në të gjitha fazat e prodhimit, ruajtjes, tregtimit dhe transportit të produkteve të tilla;
- l Të sigurojë se për produktet, për të cilat zbatohet ky Ligj janë kryer testet, standardet, si për produktet e destinuara për eksport, ashtu edhe për ato për tregun e Kosovës;
- m Të vendosë nën kontroll zyrtar, kur kjo kërkohej nga SHVUK, çdo kafshë ose produkte me origjinë shtazore, derisa të ndërmerren masat përkatëse nga SHVUK;
- n Në kërkesë të SHVUK-ut të tregojë certifikatat ose dokumentet e nevojshme për kryerjen e inspektimeve në lidhje me importin të kafshëve të gjalla dhe produkteve me origjinë shtazore;
- o Të paralajmërojë me kohë Inspeksionin veterinar në pikat inspektuese kufitare në të cilat kafshët duhet të paraqiten, duke përcaktuar numrin, llojin dhe kohën e paraparë të arritjes së kafshëve;
- p Të transportojë kafshët nën mbikëqyrjen zyrtare deri në vendin e inspektimit ose, kur të jetë e mundur, në qendrën e karantinës, siç mund të urdhërohet nga SHVUK;
- q Të përcjellë paraprakisht informatat në SHVUK, duke kompletuar dokumentet përcjellëse, certifikatat ose dokumentat e dorëzuar nga shërbimi i inspektimit, ose duke ofruar përshkrim të detajizuar, me shkrim ose në formë të kompjuterizuar, të çfarëdo dërgese të prodhimeve me origjinë shtazore, duke përfshirë produktet biologjike, spermen, qelizat dhe embrionet, nënproduktet dhe produktet bimore që u nënshtrohen kërkesave veterinarë;
- r Të paguaj taksat relevante për inspektime dhe kontrole të përcaktuara me këtë nen, ose në Udhëzimet Administrative që mund të nxirren sipas tij;
- s Asistojë dhe bashkëpunojë me SHVUK në çdo aktivitet, të urdhëruar nga SHVUK që ka të bëjë me tregtinë e kafshëve dhe produkteve shtazore dhe hulumtimet e kryera në pikat e kontrollit kufitar; dhe
- t Ndërmerr cilindo trajtim ose dezinfektim të kafshëve që mund të kërkohej nga SHVUK.

## Detyrimet lidhur me ushqimin e kafshëve dhe produkteve mjekësore veterinarë

### Neni 30

Pronari, mbajtësi, tregtari ose importuesi, marrësi i dërgesës, transportuesi, shitësi ose cilido person i autorizuar, sipas këtij Ligji, të shesë kafshë të gjalla, produkte me origjinë shtazore, produkte biologjike, spermë, qeliza dhe embrione, nënproduktet dhe produktet bimore që u nënshtrohen kërkesave ushqimore ose produkte mjekësore veterinarë, përfaqësuesit e personave të tillë, ose personi përgjegjës për një aktivitet privat veterinar që i nënshtrohet dispozitave të këtij Ligji duhet :

- a Merr të gjitha autorizimet përkatëse nga SHVUK para plasimit në treg të produkteve mjekësore veterinarë;
- b Në kërkesë të SHVK-ut të ofrojë, studime, rezultate ose informata që ndërlidhen me ushqim të kafshëve ose produkte mjekësore veterinarë;
- c Të respektojë çdo rregull që kufizon ose ndalon tregëtinë e produkteve mjekësore veterinarë, vendimin për shkatërrimin e ushqimeve të kafshëve ose produkteve mjekësore veterinarë që paraqesin kërcënim serioz për shëndetin e kafshëve ose për shëndetin publik;
- d Të paguajë taksat përkatëse për inspektimet dhe kontrollat e referuara në këtë nen ose në çfarëdo Udhëzimi Administrativ që mund të nxirret sipas tij, dhe
- e Të asistojë dhe bashkëpunojë me shërbimet veterinarë në çdo aktivitet të urdhëruar nga SHVUK që ndërlidhet me tregëtimin e kafshëve dhe produkteve shtazore dhe hulumtimet e kryera në pikat e inspektimit kufitar.

## Aktivitetet profesionale veterinarë Oda e Veterinerëve

### Neni 31

Veterinerët e Kosovës themelojnë një Odë të quajtur Oda e Veterinerëve (në tekstin e mëtutjeshëm “Oda”) e cila ushtron dhe kryen funksionet e caktuara me këtë ligj, me Udhëzimin Administrativ të nxjerrë nga Ministri dhe me statutin e Odës.

## Aktivitetet profesionale veterinarë

### Neni 32

32.1. Aktivitetet profesionale përbëhen nga aktivitetet veterinarë publike dhe ato private.

32.2. Askush nuk e ushtron profesionin e veterinarës përveç nëse:

- a Posedon liçensën për praktikë të lëshuar nga Ministria ; dhe
- b Emri i tij është regjistruar në Regjistrin e Veterinerëve.

32.3. Liçensat u jepen vetëm aplikantëve të cilët :

- a Kanë diplomuar në medicinën dhe kirurgjinë veterinare dhe kanë diplomën ose kualifikimin formal superior.

32.4. Ministri, me propozim të SHVUK, mund të liçensojë teknikët e veterinës që të kryejnë trajtime të vogla të shtazëve dhe të ndërmarrin procedurat si mbarsimi artificial, gjithnjë nën mbikëqyrje direkte ose indirekte të veterinerit. Ministri duhet të nxjerrë Udhëzim Administrativ për punët që mund t'i kryejnë teknikët e licensuar të veterinës.

#### Aktivitetet private veterinare

##### Neni 33

33.1. Ministri, pas konsultimit me SHVUK, mund të nxjerrë Udhëzim Administrativ për regjistrimin e veterinerëve që ushtrojnë aktivitetet e veterinës private, definicionin e aktiviteve të veterinës private dhe kryerjen e aktiviteve të veterinës private.

33.2. Ushtruesi i veterinës private ka këto të drejta:

- a Në marrëveshje me pronarin e kafshës ose punëdhënësin, mund të paguhet ose të marrë rrogë për kujdesin mjekësor veterinar që i jepet kafshës;
- b T'i shesë barna pronarit të kafshës sipas nevojës për trajtimin e kafshës;
- c T'i përshkruaj recetën pronarit të kafshës për blerjen e barnave dhe produkteve mjekësore veterinare në barnatore;
- d T'i blejë barnat dhe produktet mjekësore veterinare në njësitë farmaceutike për qëllim të praktikës së mjekësisë veterinare; dhe
- e Të refuzojë kryerjen e kujdesit mjekësor veterinar nëse puna përkatëse që duhet të kryhet nuk është në pajtim me kërkesat e kualifikimit profesional të veterinerit ose është në kundërshtim me dispozitat e këtij Ligji, ose me dispozitat tjera të akteve legjislative mbi mjekësinë veterinare dhe/ose etikën e punës së veterinerit si dhe në rastet kur pronari i kafshës nuk ofron kushte të sigurt të punës për shëndetin dhe jetën e veterinerit në pajtim me dispozitat e këtij Ligji ose çfarëdo Udhëzimi Administrativ të nxjerrë sipas tij.

33.3. Teknikët e licensuar të veterinës mund të paguhen nga pronarët e kafshëve për shërbimet që ata ofrojnë nën mbikëqyrjen e veterinerit.

#### Aktivitetet e veterinës publike

##### Neni 34

34.1. Ministri mund të nxjerrë Udhëzim Administrativ për emërimin e veterinerëve përgjegjës për aktivitetet e veterinës publike brenda SHVUK dhe kryerjen e aktiviteve të veterinës publike.

34.2. Ushtruesi i veterinës ka këto të drejta:

- a Të bëjë marrëveshje me SHVUK-un për marrjen e masave të specifikuara në programet preventive dhe monitoruese për sëmundjet infektive të kafshëve, me kusht që pagesat për shërbime të tilla të përcaktohen nga Ministri në konsultim me KEV-in.
- b Të bëjë marrëveshje me KEV-in, në baza konkurrençe, për kryerjen e shërbimeve që kërkojnë ekspertizë veterinarë.

34.3. Teknikët e licencuar të veterinës mund të paguheshin përmes SHKUV-it për shërbimet e aprovuara që ata mund të ofrojnë, të mbikëqyrur nga veterineri i licencuar. Nga ata mund të kërkojë raportimi i rregullt te KEV, në pajtim me formatin e përcaktuar, mbi aktivitetet dhe monitorimin e sëmundjeve të kafshëve.

#### Shkelja e detyrimeve

##### Neni 35

35.1. Kur konstatohet se veterineri apo tekniku i licencuar i veterinës nuk ka pëmbushur ndonjë obligim ose kusht të përcaktuar në këtë Ligj, ose ka cenuar ndonjë dispozitë të ligjeve të aplikueshme, SHVUK mund ta pezullojë ose anulojë regjistrimin e veterinerit apo teknikut të licencuar të veterinës nga Regjistri i Veterinerëve.

35.2. Kundër vendimit të SHVUK për suspendimin apo anulimin e regjistrimit, veterineri apo tekniku i licencuar i veterinës mund të ushtrojë ankesë te Ministri.

#### Inspekcioni Veterinar

##### Neni 36

36.1. Kontrollin veterinar të objekteve, paisjeve dhe ushqimeve me prejardhje shtazore e bëjnë Inspektorët veterinarë të Ministrisë në përputhje me kompetencat e tyre, të cilët kanë të drejtat me sa vijon:

- a Të vizitojnë pa paralajmërim objektet nën mbikëqyrjen e SHVUK-ut, të kërkojnë dokumente dhe informacion, të marrin mostrat për hulumtim laboratorik në përputhje me programet monitoruese qeveritare dhe nëse ekziston dyshimi se kafshët mund të jenë të sëmura nga sëmundjet infektive të monitoruara nga SHVUK si dhe në raste dyshimi apo ankesave që kanë të bëjnë me shkeljen e ligjeve dhe akteve nënligjore;
- b Të pezullojnë apo ndalojnë përkohësisht veprimtarinë e subjekteve që janë nën mbikëqyrjen e SHVUK-ut, organizimin e garave të kafshëve, tregjeve, ankandeve, ekspozitave dhe ngjarjeve të tjera, nëse ka dyshim se kafshët janë sëmurë nga sëmundje infektive, nëse ka rrezik për shëndetin e njeriut apo të kafshëve, si edhe në rastet kur shkelen kërkesat ligjore;
- c Në rastet e shkeljes, të ushtrojnë fletëparaqitje ndaj individëve në përputhje me procedurat e vendosura me ligj;

- d Në rast nevojë mund të kërkojnë ndihmë tek organi i sigurimit publik dhe të institucioneve të tjera për zbatimin e ligjit, në mënyrë që të sigurohet plotësimi i detyrave të tyre; dhe
- e Të pezullojnë shitjen e produkteve me origjinë shtazore, nëse ato paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut apo të kafshëve, sikurse dhe të kontrollojnë asgjësimin apo shfrytëzimin e produkteve përkatëse.

36.2. Inspektorët veterinarë nuk mund:

- a Të marrin pjesë në veprimtaritë ekonomike të subjekteve që i nënshtrohen kontrollit; dhe
- b Të kryejnë punë veterinarë, duke përfshirë ekspertizën veterinarë, rezultati i së cilës duhet të kontrollohet nga ata.

36.3. Inspektorët veterinarë janë përgjegjës për pajtueshmërinë e urdhërave e të vendimeve që marrin dhe veprimeve të kryera, me kërkesat e dispozitave ligjore.

36.4. Kundër urdhërave dhe vendimeve të inspektorëve veterinarë mund të ushtrohet ankesë te Ministri. Pala e pakënaqur me vendimin e Ministrisë mund të iniciojë procedurën në Gjykatë.

36.5. Ankesa ndaj urdhërave dhe vendimeve të inspektorëve veterinarë nuk pezullojnë zbatimin e tyre.

#### Kontrolli veterinar në vendkalimet kufitare dhe nëpër depot doganore

##### Neni 37

37.1. Kontrolli veterinar në kufirin e vendit dhe nëpër depot doganore kryhet nga Inspektorët Veterinarë.

37.2. Autoriteti kompetent përcakton:

- a Ngarkesat e mallrave, të cilat gjatë importit, tranzitit dhe eksportit janë objekt i kontrollit veterinar;
- b Pikat e kontrollit kufitar nëpër të cilat mund të transportohen ngarkesat e mallrave që janë objekt i kontrollit veterinar;
- c Kërkesat për organizimin e pikave të kontrollit kufitar në të cilat kryhen kontrollet veterinarë dhe procedurat për aprovimin e tyre;
- d Pikat dezinfektuese – preventive;
- e Procedurat sipas të cilave kryhen kontrollet veterinarë në vijën kufitare dhe administrative të Kosovës dhe nëpër depot doganore;
- f Procedurat dhe listat e çmimeve që kanë të bëjnë me pagesën e kontrollit veterinar; dhe
- g procedurat që kanë të bëjnë me paraqitjen dhe lëshimin e çertifikatës së kontrollit veterinar për ngarkesat e mallrave që kalojnë kufirin.



Funksionet dhe detyrat e Laboratorit Veterinar të Kosovës  
Udhëheqësi i Laboratorit Veterinar të Kosovës.

Neni 38

38.1. Laboratori Veterinar i Kosovës ushtron funksionet dhe detyrat e përcaktuara me këtë Ligj dhe drejtohet nga Udhëheqësi i Laboratorit Veterinar të Kosovës, i cili duhet të jetë veteriner i licencuar. Në mungesë të emërimit të Udhëheqësit të Laboratorit Veterinar të Kosovës, të gjitha funksionet përkatëse publike, detyrat dhe përgjegjësitë ekzekutohen nga KEV.

38.2. Laboratori Veterinar i Kosovës ushtron këto funksione:

- a Përgatit raporte për shërbimet veterinarë mbi barnat veterinarë;
- b Kryen ekzaminimet post mortem, analizat biologjike, diagnostifikimet dhe analizat laboratorike, dhe testimet e mbetjeve;
- c Publikon raportin vjetor të mbikëqyrjeve duke regjistruar të gjitha ekzaminimet e kryera dhe të gjitha sëmundjet, infeksionet dhe intoksikimet e identifikuara.

Funksionet në lëmin e veterinars

Neni 39

Laboratori Veterinar i Kosovës kryen funksionet e tij të ndërlidhura me ekzaminimet post mortem, analizat mikrobiologjike, diagnostifikimet dhe analizat laboratorike ose të ngjashme në identifikimin e mbetjeve në pajtim me procedurat dhe standardet ndërkombëtarisht të njohura dhe merr pjesë në testet krahasuese në nivele ndërkombëtare.

Funksionet që ndërlidhen me ushqimet e kafshëve

Neni 40

Ministri mund të nxjerrë Udhëzim Administrativ për të rregulluar mënyrën në të cilën Laboratori Veterinar i Kosovës i kryen hulumtimet që lidhen me veterinars dhe shëndetin publik në aditivë dhe në produktet dhe substancat e padëshirueshme që mund të jenë inkorporuar në ushqime dhe produkte të përdorura në ushqimin e kafshëve dhe metodat që duhen përdorur për mostrimin dhe analizat e ushqimeve të kafshëve dhe vlerësimin e produkteve dhe aditivëve.

Funksionet në lëmin e produkteve mjekësore veterinarë

Neni 41

41.1. Laboratori Veterinar i Kosovës:

- a Asiston organin kompetent që të vendosë në bazë të kërkesës së parashtruar nga prodhuesi, ose përfaqësuesi i autorizuar për produktet mjekësore veterinarë për përdorim në kujdesin e shëndetit të kafshëve, me qëllim të marrjes së autorizimit për tregtimin e produkteve në pajtim me dispozitat e këtij Ligji;

- b Përgatit dhe azhuron raportet vlerësuese rreth rezultateve të testeve analitike dhe farmako-toksikologjike dhe provave klinike të produkteve mjekësore veterinarë;
- c Mund të testojë produktet mjekësore, përbërësit e tyre aktive dhe nëse është e nevojshme edhe produktet ndërmjetëse ose materialet e tjera përbërëse, ose mund të dorëzojë produktet për testim në laborator në vendin tjetër apo në laboratorin e caktuar për atë qëllim, për t'u siguruar se metodat dhe rezultatet e testimit të dhëna nga prodhuesi në aplikacion janë të kënaqshme;
- d Ndhmon autoritetin kompetent që të vendosë për përdorim të mëtutjeshëm ose për ndalim të përdorimit të një produkti mjekësor veterinar në rastet kur është detektuar ndonjë efekt i padëshirueshëm;
- e Në bazë të referencës që i është bërë, teston nëse një produkt mjekësor veterinar ose substancat e tjera të pa dëshirueshme që janë përdorur e kanë kontaminuar një prodhim të caktuar,
- f Këshillon SHVUK-un për mbikëqyrjen e prodhimit, paraqitjes, shpërndarjes dhe përdorimit të prodhimeve mjekësore veterinarë, dhe
- g Studjon situatën epizootologjike të vendit, dhe cakton diagnozën e sëmundjeve infektive nga lista A, atyre zoonotike si dhe të toksoinfeksioneve, njëherit ndihmon në përpilimin e masave dhe programeve të luftimit dhe parandalimit të sëmundjeve.

41.2. Ministri mund të nxjerrë Udhëzim Administrativ për implementimin e dispozitave të këtij neni.

## Funksionet që ndërlidhen me shëndetin publik veterinar

### Neni 42

42.1. Ministri rregullon me Udhëzim Administrativ sipas këtij ligji kërkesat veterinarë dhe higjienike në therrtore dhe llojet e kafshëve që lejohen të therrren në therrtore.

42.2. SHVUK organizon dhe definon procedurat për inspektime para dhe pas therrjes së kafshëve për therrje.

42.3. Kafshët shtëpiake, kafshët e egra, bletët, peshqit dhe produktet e tyre shpërndahen vetëm pas inspektimit veterinar dhe çertifikimit nga veterineri i autorizuar dhe në pajtim me mendimin e tij/saj përsa i përket përdorimit të mëtutjeshëm .

42.4. Pronarët e therrtoreve detyrohen të sigurojnë se kanë plotësuar kërkesat për kushtet e domosdoshme të punës për kryerje të inspektimeve veterinarë.

42.5. Pronarët e kafshëve që mendojnë të shesin kafshët për therrje për konsum njerëzor duhet t'i therrin kafshët e tyre në therrtoren e autorizuar nga KEV në pajtim me procedurat e përcaktuara .

42.6. Ministri mund të nxjerrë Udhëzim Administrativ sipas këtij ligji për higjienën dhe kriteret e inspektimit në objektet, përfshirë fermat, të cilat grumbullojnë ose përpunojnë qumësht dhe objektet që përpunojnë mishin apo produktet e mishit.

## Ndihma

### Neni 43

Me qëllim të zbatimit të dispozitave të këtij Ligji, SHVUK mund të kërkojë ndihmë nga Shërbimi Policor ose nga shërbimet e tjera dhe sipas nevojës formohet Këshilli Emergjent i përbërë nga përfaqësuesit e Shërbimit Policor dhe shërbimeve tjera, të cilët takohen rregullisht me qëllim të azhurnimit të planeve emergjente SHVUK mund të kërkojë asistencën e tillë:

- a Kur veterinerët zyrtarë autorizohen nga dispozitat e këtij Ligji për të kryer inspektimet dhe mbikëqyrjen në lidhje me kufizimet në tregtimin e kafshëve ose ndalesat e lëvizjeve të personave ose kafshëve në zonat e kontaminuara;
- b Në rastet e shpërthimit të sëmundjeve epizootike për parandalimin e përhapjes së sëmundjes dhe eliminimin e sëmundjeve ngjitëse të kafshëve, dhe
- c Kur zyrtarët veterinerë gjatë kryerjes së detyrave dhe funksioneve të tyre në pajtim me dispozitat e këtij Ligji, konfrontohen me rezistencë fizike ose pengohen në ndonjë fermë tjetër ose kur rezistenca ose pengimi i tillë është i pritshëm me arsye.

## Pengimi i veterinerit zyrtar

### Neni 44

Asnjë person nuk mund të:

- a Sulmojë, t'i rezistojë apo të pengojë me paramendim veterinerin zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij/saj sipas këtij Ligji,
- b Refuzon ose neglizhon të zbatojë çfarëdo vendimi ose udhëzimi të nxjerrë sipas këtij Ligji,
- c Pa arsye:
  - i Nuk përgjigjet pyetjeve të parashtruara nga veterineri zyrtar,
  - ii (ii) Nuk paraqet atë që i kërkohet në pajtim me dispozitat e këtij Ligji,
- d Pamundëson kërkimin ose inspektimin sipas këtij Ligji,
- e Parandalon ose tenton të parandalojë personin tjetër të zbatojë urdhërat ose udhëzimet, të përgjigjet në pyetje, të paraqes atë që i kërkohet, ose të mundësojë hulumtimin ose inspektimin;
- f Me qëllimin e marrjes së liçencës a lejes ose të ofrimit të çfarëdo informacioni për përbushjen e kushteve të kërkuara me këtë Ligj, ofron informata të cilat ai i di se janë të rreme ose nga pakujdesia ofron informata që janë të rreme.

## Dispozitat ndëshkimore.

### Neni 45

45.1. Dënohet për kundërvajtje me gjobë nga 5.000 deri në 50.000 Euro personi që:

- Nuk i zbaton masat e urdhëruara për parandalimin e shfaqjes së sëmundjeve infektive;
- Nuk i zbaton masat e urdhëruara për luftimin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive;
- Zhvendos apo vë qarkullim kafshët brenda apo jashtë vendit pa certifikatë veterinare shëndetësore;
- Importon, eksporton ose i kalon tranzit jashtë vendkalimeve të caktuara kufitare dhe pa kontrollë veterinare kufitare kafshet dhe ngarkesat e mallrave që janë objekt i kontrollit veterinar;
- Importon kafshë dhe produkte me origjinë shtazore në vend dhe i kalon ato tranzit në kundërshtim me kufizimet ose ndalesat e inspektorit veterinar;
- Therr kafshë pa e kryer inspektimin dhe ekspertizën veterinare;
- Ushtron veprimtarinë në therrorë që nuk i plotesojnë kushtet veterinare dhe higjienike;
- Therr kafshë që nuk janë të lejuara të therrren në therrtorë;
- Ben distribuimin e produkteve të mishit, kafshëve të gjahut, produkteve të terura dhe të ngrira të peshkut dhe produkteve të tjera të papërpunuara me origjinë shtazore pa ekspertizë veterinare nga veterineri i autorizuar;
- Shet produkte ushqimore të papërpunuara me origjinë shtazore dhe produkte ushqimore shtëpiake me origjinë shtazore për të cilat egziston kufizimi i shitjes;

45.2. Dënohet me gjobë për kundërvajtje nga 500 deri në 30.000 Euro, personi që:

- Nuk i ndërmer masat nga nenet 27 dhe 29 të këtij ligji;
- Ushtron apo kryen pa leje praktikën dhe ekspertizën veterinare;
- Shpërndan apo shet produkte ushqimore të papërpunuara me origjinë shtazore apo produkte ushqimore shtëpiake me origjinë shtazore në tregjet e paautorizuara;
- Organizon gara të kafshëve, tregje, ankande, ekspozita dhe ngjarje të tjera për kafshët, pa lejen e inspektorit kompetent;
- Nuk i lajmëron sëmundjet gjatë transportimit të kafshëve;
- Bën qarkullimin e produkteve me origjinë shtazore i pa autorizimin e SHVUK-ut;
- Nuk bën trajtimin e kafshëve të egra të mbytura dhe distribuimin e tyre sipas procedurave të përcaktuara;
- Përdor medikamente dhe produkteve farmaceutike të pa autorizimin e SHVUK-ut;
- Nuk i përmbush detyrimet nga neni 32 i këtij Ligji;
- Nuk i lajmëron trupat e ngordhur të pavarrosura të kafshëve të egra ;

- Pengon regjistrimin e fermave, matrikulimin e kafshëve dhe kopeve, shenjzimin e tufave apo kontrollin e lëvizjes së kafshëve;
- Nuk i zbaton urdhërat dhe vendimet e inspektorit veterinar

45.3. Kur personi dënohet për shkelje të këtij Ligji, gjyqi, përveç dënimit që mund t'i shqiptojë, mund të urdhërojë që instrumentet, pajisjet, produktet ose substancat e përdorura gjatë kryerjes së shkeljes t'i konfiskohen dhe të shkatërrohen, në mënyrën që gjyqi e përcakton në bazë të këshillës së ekspertëve.

45.4. Në rast të shpalljes fajtor për herë të dytë ose të njëpasnjëshme në pajtim me dispozitat e këtij Ligji, personit të shpallur fajtor, përveç dënimit tjetër, i konfiskohet liçensa ose leja dhe i ndalohet regjistrimi i mëvonshëm në regjistër sipas këtij ligji për periudhën deri në tri vjet. Personit të shpallur fajtor, përveç dënimit të shqiptuar, gjyqi gjithashtu mund të vendosë t'i konfiskohet çfarëdo takse e paguar për liçensë ose leje.

#### Neni 46

Të gjitha pagesat që rrjedhin nga aplikimi i dispozitave ndëshkuese të këtij ligji derdhën në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

#### Fuqitë e rezervuara për PSSP

#### Neni 47

Të gjitha funksionet e rezervuara të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për Kosovën (PSSP) sipas Rregullores së UNMIK-ut nr.2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, përkohësisht janë lëndë e monitorimit dhe e miratimit të PSSP-së.

#### Dispozitat perfundimtare

#### Neni 48

Ky Ligj shfuqizon çdo dispozitë të Ligjit në fuqi nga lëmia e veterinarisë që është në kundërshtim me të.

#### Hyrja në fuqi.

#### Neni 49

Ky Ligj hyn në fuqi pas aprovimit nga Kuvendi i Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP).

**Ligji Nr.2004 / 21**  
**16 Qershor 2004**

**Kryetari i Kuvendit të Kosovës,**  

---

**akademik Nexhat Daci**

## PROGRAMI I PARË

Sëmundjet të cilat duhet të lajmërohen, të referruara në nenin 8:

Afta epizootike  
Sëmundja vesikulare e derrit  
Mortaja e dhive (Peste des petits ruminants)  
Sëmundja e lëkurës me xhunga  
Gjuha e kaltërt  
Sëmundja e kalit afrikan  
Ethet klasike të derrit  
Sëmundja Newcastle  
Stomatiti vesikular  
Mortaja e gjedhit  
Pleuropneumonia ngjitëse e gjedhit  
Ethet Rift Valley  
Lija e deles dhe e dhisë  
Ethet afrikane të derrit  
Avian influenza shumë patogjenike  
Encefalofatia spongiforme e gjedhit  
Zgjeba  
Antraksi  
Tërbimi  
Tuberkulozi i gjedhit  
Brucelloza e gjedhit, brucelloza e dhisë dhe deles  
Leukoza enzootike e gjedhit  
Trikinosa

PROGRAMI I DYTË  
Sëmundjet e shumë racave

Sëmundja e Aujeskit  
Ekinokoku/hidatidoza  
Sëmundja e ujit në zemër  
Leptospiroza  
Cochliomyia hominivorax  
Chrysomya bezziana  
Paratuberkuloza  
Ethet Q

Sëmundjet e deleve dhe dhive  
Artriti/encefaliti i dhisë  
Agalaktia ngjitëse  
Pleuropneumonia ngjitëse e dhisë  
Abortimi enzootik i delve (klamidioza e deles)  
Maedi-visna  
Sëmundja Nairobi e deleve  
Epididimiti i deleve (Brucella ovis)  
Adenomatoza pulmonare e deles  
Salmonella (S. abortusovis)

Sëmundjet e derrit  
Riniti atrofik i derrit  
Encefalomeliti enterovirus  
Brucelloza e derrit  
Cisterioza e derrit  
Sindromi reprodaktiv dhe respirator i derrit  
Gastroenteriti ngjitës

Sëmundjet lagomorfe  
Muksomatoza  
Sëmundja hemorragjike e lepurit  
Tularemia

Sëmundjet e peshkut  
Nekroza hematopoetike epizootike  
Nekroza infektive hepatopoetike  
Sëmundja virusale Oncorhynchus masou  
Viramia pranverore e krapit  
Septikamia hemorragjike virale

Sëmundjet e Krustaceve  
Sindromi taura  
Sëmundja e pikave të bardha  
Sëmundja e kokës së verdhë

Sëmundjet e gjedhit  
Anaplazmoza e gjedhit  
Babesioza e gjedhit  
Brucelloza e gjedhit  
Cisterioza e gjedhit  
Kampilobakterioza gjenitale e gjedhit  
Dermatofiloza  
Septikamia hemorragjike  
Rinotrakeiti infektiv i gjedhit /vulvovaginiti infektiv pustular  
Ethet malinje katarrale  
Teilerioza  
Trikomonoza  
Tripa nosomoza

Sëmundjet e kalit  
Metriti ngjitësi kalit  
Tripanozomoza  
Limfangjiti epizootik  
Encefalomeliti i kalit (lindor dhe perëndimor)  
Anemia infektive e kalit  
Gripi i kalit  
Piroplazmoza e kalit  
Rinopneumoniti i kalit  
Arteriti viral i kalit  
Kërrnjotë  
Zgjeba e kalit  
Lija e kalit  
Encefaliti Japonez  
Tripanozomoza e deve (Trypanosoma evansi)  
Encefalomeliti Venezuelian i kalit

Sëmundjet aviane (të shpezëve)  
Klamidioza aviane  
Bronkiti infektiv avian  
Laringotrakti infektiv avian  
Mukoplazma aviane (M. gallisepticum)  
Tuberkuloza aviane  
Enteriti viral i rosës  
Hepatiti viral i rosës  
Kolera e shpezëve  
Lija e shpezëve  
Tifoja e shpezëve  
Sumundja infektive e Bursës (sëmundja Gumboro)  
Sëmundja e Marek-ut  
Sëmundja pullorum



Sëmundjet e bletëve  
Akarioza e bletëve  
Pesta Amerikane  
Pesta Europiane  
Nosemoza e bletëve  
Varroza

Sëmundjet mullosk  
Bonamioz (Bonamia ostreae, B. exitiosus, Mikrocytos roughleyi)  
Marteilioza (Martellia refringens, M. sydneyi)  
Mikrocitoza (Mikrocytos mackini)  
Sëmundja MSX (Haplosporidium nelsoni)  
Perkinsoza (Perkinsus marinus, P. olseni/atlanticus)

Sëmundjet tjera  
Leishmaniosis

## PROGRAMI I TRETË

### PJESA A

Produktet mjekësore veterinare të zhvilluara me anë të një nga proceset e mëposhtme bioteknologjike:

1. teknologjinë rekombinuase ADN;
2. futjet e kontrolluara të gjeneve duke koduar proteinat aktive biologjike në prokariotë dhe eukariotë duke përfshirë qelizat e transformuara sisore;
3. hibridomë dhe metoda monoklonale anti-trupa;

Produktet mjekësore veterinare, përfshirë ato që nuk rezultojnë nga bioteknologjia, të menduara kryesisht për përdorim si ngritës së performancës me qëllim të nxitjes së rritjes së kafshëve të trajtuara ose të ngrisin rendimentet nga kafshët e trajtuara.

### PJESA B

Produktet mjekësore veterinare të zhvilluara nga proceset tjera bioteknologjike, të cilat sipas mendimit të Laboratorit Veterinar të Kosovës paraqesin risi të rëndësishme.

Produktet mjekësore veterinare të administruara me anë të sistemeve të reja të dërgimit, të cilat sipas mendimit të Laboratorit Veterinar të Kosovës paraqesin risi të rëndësishme.

Produktet mjekësore veterinare të prezentuara për indikacion plotësisht të ri, të cilat sipas mendimit të Laboratorit Veterinar të Kosovës janë me interes të rëndësishëm terapeutik.

Produktet mjekësore veterinare të bazuara në radio-izotope, të cilat sipas mendimit të Laboratorit Veterinar të Kosovës janë me interes të rëndësishëm terapeutik.

Produktet mjekësore veterinare prodhimi i të cilave përdor procese, të cilat sipas mendimit të Laboratorit Veterinar të Kosovës demonstroi përparim të rëndësishëm teknologjik si elektroforeza dy dimensionale nën mikro-gravitet.

Produktet mjekësore veterinare të menduara në kafshët prodhuese të ushqimit që përmbajnë substancë të re, e cila në datën e futjes së këtij Ligji në fuqi, nuk është autorizuar nga Kosova për përdorim në kafshët prodhuese të ushqimit.

## PJESA C

Organizmi i modifikuar gjenetisht (OMG) nënkupton organizmin, në të cilin materiali gjenetik është ndryshuar në mënyrën që nuk paraqitet prej natyre gjatë ndërzimit dhe/ose rekombinimit natyror.

Brenda kuptimit të këtij definicioni, modifikim gjenetik paraqitet së paku gjatë përdorimit të teknikave të gjenetikës të cilat, ku përveç tjerash, janë:

1. teknikat rekombinuase ADN që përdorin sisteme vektorë;
2. teknikat që përfshijnë futjen direkte në organizëm të materialit të trashëgueshëm të përgatitur jashtë organizimit përfshirë mikro-injektimin, makro-injektimin dhe mikro-enkapsulimin.
1. fuzioni qelizor (përfshirë fuzionin e protoplastës); ose
2. teknikat e hibridizimit kur qelizat e gjalla me kombinimet e reja të materialeve të trashëgueshme gjenetike formohen përmes fuzionit të dy ose më shumë qelizave me anë të metodave që nuk paraqiten në mënyrë natyrore.

Teknikat që nuk konsiderohen të rezultojnë në modifikim gjenetik, me kusht që ato nuk involvojnë përdorimin e molekulave rekombinuase ADN ose OMG, janë

1. induksioni poliploid,
2. mbarësimi in vitro,
3. konjugimi, transduksioni, transformimi ose cilido proces tjetër natyror.